



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/262

Datë: 11.06.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Këshilli Organizativ për varrimin e ish-Kryeministrit Bujar Bukoshi, në këtë përbërje:
 - 1.1. Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesues;
 - 1.2. Ministri i Mbrojtjes, anëtar;
 - 1.3. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, anëtare;
 - 1.4. Përfaqësues, Zyra e Kryeministrit, anëtar.
2. Ftohen që të dërgojnë nga një përfaqësues në Këshill:
 - 2.1. Përfaqësues, Zyra e Presidentes, anëtar;
 - 2.2. Përfaqësues, Kuvendi i Republikës së Kosovës, anëtar;
 - 2.3. Përfaqësues i Familjes Bukoshi, anëtar.
3. Familjes Bukoshi i ndahen mjete në shumë prej 10,000€ (dhjetëmijë eurosh), nga Buxheti i Zyrës së Kryeministrit, kodi 10700, Kabineti i Kryeministrit.
4. Me kërkesë të Kryesuesit të Këshillit Organizativ, mund të ftohen edhe anëtarë të tjerë për realizimin e aktiviteteve, sipas nevojave të Këshillit Organizativ.
5. Obligohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Këshilli Organizativ për zbatimin e këtij Vendimi.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/262

Datë: 11.06.2025

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 7, paragrafi 5, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi për të kërkuar nga Presidentja e Republikës së Kosovës dhënien e autorizimit Ministrit të Mbrojtjes për nënshkrimin e Marrëveshjes Kornizë për Bashkëpunim në Fushën e Mbrojtjes, ndërmjet Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Mbrojtjes, dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, e përfaqësuar nga Departamenti i Mbrojtjes.
2. Rekomandohet Presidentja e Republikës së Kosovës për dhënien e autorizimit Ministrit të Mbrojtjes për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij Vendimi, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI

Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/262

Datë: 11.06.2025


Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, nenit 80 të Ligjit Nr. 06/L- 026 për Azil, në pajtim me nenet 65 dhe 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 11 qershor 2025, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në kuadër të bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, e vlerëson të nevojshëm ofrimin e mbrojtjes së përkohshme dhe të menjëhershme për pesëdhjetë (50) persona.
2. Identifikimi dhe përzgjedhja e personave subjekt të pikës 1. të këtij Vendimi, do të bëhet në bashkëpunim me autoritetet relevante të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
3. Personat subjekt të pikës 1. të këtij Vendimi, gjatë kohës së qëndrimit në Republikën e Kosovës, do të veprojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe do të gëzojnë të drejtat e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Mbrojtja e përkohshme dhe e menjëhershme nuk do të paragjykojë njohjen e statusit të refugjatit apo mbrojtjes plotësuese, nëse personat si në pikën 1. të këtij Vendimi e kërkojnë një mbrojtje të tillë.
5. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme të fillojë përgatitjet e duhura për ofrimin e mbrojtjes së përkohshme, bashkërendimin e këtij procesi, integrimin e personave subjekt i këtij Vendimi, përkrahjen mujore financiare në vlerë monetare prej 120€ (njëqind e njëzet euro) për person. Shpenzimet do të mbulohen nga "Programi i Ri integrit", kodi buxhetor 20900.
6. Obligohet Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve që të sigurojë mjetet e nevojshme buxhetore për Ministrinë e Punëve të Brendshme me qëllim të zbatimit të këtij Vendimi.
7. Obligohen institucionet relevante të bashkëpunojnë me Ministrinë e Punëve të Brendshme gjatë procesit të ofrimit të mbrojtjes së përkohshme.
8. Ofrimi i mbrojtjes së përkohshme do të bëhet në pajtim me procedurat e parapara në Ligjin Nr. 06/L-026 për Azil dhe do të ketë efekt nga data e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

9. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë